

Instituti për Studime të Avancuara GAP

Shtime – Raporti komunal

Tetor 2009

Shtimja në shifra

Popullsia	Gjithsej	30,408
	Shqiptarë	97.3%
	Ashkalinjë	2.6%
	Të tjerë	0.1%
Gjeografia	Sipërfaqja (km ²)	134
	Numri i fshatrave	22
Shkollimi	Pa shkollë/fillore e papërfunduar	19.64%
	Filllore/e mesme e papërfunduar	37.53%
	E mesme	36.65%
	Shkollë e lartë	5.57%
	Universitet	0.59%
	Nr. i nxënësve	7,645
	Nr. i mësimdhënësve	371
	Nr. i shkollave të mesme (me paralele të ndara)	1
	Nr. i shkollave fillore (me paralele të ndara)	19
	Nr. i çerdheve	0
	Shëndetësia	Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare
Qendra të Mjekësisë Familjare dhe punkte shëndetësore		3
Nr. i mjekëve		17
Papunësia	Gjithsej	49.21%
	Meshkuj	44.66%
	Femra	64.55%
Të punësuar	Fuqi punëtore (15-64 vjet)	18,549
	Të punësuar në sektorin publik komunal	623
Buxheti 2009	Gjithsej (Euro)	3,234,082
	Të hyrat vetanake të planifikuara (Euro)	310,623
	Të hyrat tjera (Euro)	2,923,459
Shpenzimet e realizuara (2008)¹	Gjithsej (Euro)	2,599,884 (92%)
	Shpenzimet kapitale (Euro)	263,795 (61%)
	Shpenzimet tjera (Euro)	2,336,089 (97%)
Rezultatet e zgjedhjeve lokale 2007	PDK	46.17%
	LDK	15.16%
	LDD	12.75%
	AKR	10.89%
	AAK	5.68%
	Halil Halili	5.04%
	Tjera	4.31%
Kryetarët e Komunës 1999-2009	2000-2002: Fehmi Mujota (PDK) 2002-2007: Fatmir Rashiti (PDK) 2007-2009: Naim Ismajli (PDK)	

¹ Në kllapa ndodhen përqindjet e shpenzimit të buxhetit që ka qenë në dispozicion.

Shkurt për Shtimen

Komuna e Shtimes gjendet në pjesën qendrore të Kosovës. Me një sipërfaqe prej 134 km², kjo komunë përbënë 1.2% të tërë territorit të Kosovës. Për nga madhësia territoriale Shtimja radhitet e 25 në Kosovë në krahasim me komunitat tjera. Kjo komunë ka 30,400 banorë që jetojnë në qytet dhe 22 fshatra të kësaj komune. 62,5% e popullsisë jeton nëpër fshatra. Edhe për nga numri i fshatrave Shtimja radhitet e 27 në krahasim me komunitat tjera. 13 fshatra të kësaj komune shtrihen në pjesën kodrinore-malore, kurse 9 në pjesën e rrafshët të territorit të kësaj komune. Në territorin e komunës së Shtimes në kohërat e lashta ka kaluar rruga e njohur Via Egnatia. Në historinë më të re të Kosovës, kjo komunë njihet edhe për një fakt të dhimbshëm. Në Reçak të Shtimes në janar 1999 forcat serbe kryen masakrën më të rëndë në Kosovë. Këtë rast ambasadori i OSBE William Walker e quajti si krimin ndaj njerëzimit.

Problemet aktuale

Edhe në komunën e Shtimes, sikurse në gjithë komunitat e Kosovës, ekzistojnë problemet e papunësisë, varfërisë, zhvillimit të ulët ekonomik, rrymës, etj. Në këtë komunë, 580 familje me 2,942 anëtarë janë të varur nga ndihmat sociale. Papunësia arrin shkallën në 49.21%. Përveç këtyre problemeve, kjo komunë përballet edhe me këto probleme:

- Mungesa e furnizimit të mjaftueshëm me ujë;
- Mungesa e një çerdheje publike;
- Mungesa e stacionit të autobusëve;
- Komuna nuk ka shërbim të zjarrfikësve;
- Mungesa e aktiviteteve rinore.

Mungesa e ujit të pijes. Përderisa pushteti komunal shprehet se është bërë mjaft sa i përket ujit të pijes, qytetarët ankohen se ata përballen me probleme të shumta në këtë aspekt. Gjatë kryerjes së punimeve në rrugën kryesore të qytetit në Shtime, qytetarët kanë pasur problem me furnizimin me ujë për katër muaj. Qyteti nuk ka problem me ujë të pijes, vetëm se shtypja e ujit nuk është e mirë për shkak të gypave të vegjël të ujësjellësit. Problem me ujë të pijes kanë edhe disa fshatra në afërsi të qytetit, apo ato fshatra që shtrihen në pjesën e rrafshët të komunës. Në fshatrat Caralevë, Petroshticë dhe Zborc ekziston rrjeti i ujësjellësit që nga viti 2003, mirëpo banorët e këtyre lokaliteteve ankohen se ujë nuk ka me rregull. Edhe në fshatrat Petrovë dhe Reçak ka rrjet të ujësjellësit, por jo furnizim të mjaftueshëm me ujë. Njëjtë qëndron gjendja edhe në Vojnic dhe Gllavicë. Përveç reduktimeve të ujit, dhe gypave të vegjël që pamundësojnë furnizim të rregullt me ujë, problem mbetet edhe kualiteti i ujit. Me ujësjellësin në këtë komunë menaxhon kompania rajonale "Hidroekonomia".

Përveç furnizimit me ujë, shumë lokalitete nuk kanë rrjet të kanalizimit, si për shembull fshati Petrovë. Por edhe lokalitetet tjera që kanë rrjet të kanalizimit të gjitha i derdhin në shtratin e lumit Shtimjanka, duke ndikuar në ndotjen e tij. Kjo komunë, si gati të tërë komunitat tjera në Kosovë, nuk ka impiant për pastrimin e ujërave të zeza.

Mungesa e një çerdheje publike. Në komunën e Shtimes nuk ka çerdhe publike. Ekziston një çerdhe private në rrugën për Ferizaj, mirëpo nuk është e hapur me rregull dhe çmimet që aplikon janë të larta për buxhetin e familjeve të Shtimes. Për

sistemimin e një fëmije në çerdhen private në Shtime, e cila është rihapur këtë vit, prindërit duhet të paguajnë 50 € në muaj. Kjo shumë sipas tyre është e lartë dhe e papërbalueshme për buxhetin e familjeve. Nënata që janë në marrëdhënie pune kanë problem në sigurimin përkujdesjes për fëmijët e vegjël. Ato shprehën se një çerdhe publike (apo edhe private) me çmim më të ulët do të u lehtësonte punën atyre për të gjetur përkujdesje ndaj fëmijëve të tyre kur ato ndodhen në punë. Shumë nëna shumë prej 25€ që aplikohet në çerdhet në Ferizaj, e shohin si shumë të arsyeshme nëse do të aplikohet edhe në komunën e tyre në Shtime.

Mungesa e stacionit të autobusëve. Shtimja është një ndër qytetet e pakta në Kosovë që nuk ka stacion të autobusëve. Autobusët që qarkullojnë në Shtime zakonisht janë autobus që kalojnë vetëm transit nëpër këtë qytet, ekziston vetëm një linjë direkte Shtime-Ferizaj. Autobusët nuk kanë stacion të tyre ku të ndalohen në rast se u bie të qëndrojnë në këtë qytet, si dhe autobusët që kalojnë nëpër këtë qytet nuk kanë stacion të caktuar për marrjen e udhëtarëve. Autobusët ndalen në çdo pikë në qytet, aty ku presin udhëtarët. Ndaleja e shpeshtë dhe vend e pa vend e autobusëve nëpër qytet ndikon në bllokimin e rrugës kryesore të qytetit. Rruga kryesore e qytetit e cila është rregulluar sërish këtë vit, ka edhe trotuarin në dy anët e rrugës. Trotuari është ripunuar disa herë. Për një kohë të gjatë ky trotuar ishte vendosur në nivele të larta dhe autobusët e kanë pasur të pamundur që të lirojnë rrugën kryesore në rastin kur janë ndalur për të marrë udhëtarët.

Mungesa e stacionit të zjarrfikësve. Edhe pse në Komunën e Shtimes ekziston një zyre e zjarrfikësve, komuna nuk ka automjete dhe stacion për zjarrfikës. Në rastet kur nevojitet intervenimi i zjarrfikësve, duhet që të intervenojnë zjarrfikësit nga Ferizaj. Edhe pse nuk mund të evidentohen raste të rënda kur nga vonesa e zjarrfikësve ka pasur pasoja të mëdha, mungesa e një stacioni për zjarrfikësit mund të paraqes problem në çdo kohë. Intervenimi i zjarrfikësve nga Ferizaj kërkon kohë dhe intervenimi mund të jetë i vonuar. Qytetarët e kësaj komune dëshirojnë të kenë një stacion të tyre zjarrfikësish.

Mungesa e aktiviteteve rinore dhe kulturore. Komuna e Shtimes ende nuk ka një shtëpi të kulturës. Përderisa gjeneratat e vjetra kujtojnë me nostalgji aktivitete e tyre rinore në shtëpinë e kulturës që ka ekzistuar pranë objektit të komunës, tani ata brengosen se rinia momentalisht nuk ka objekt ku ti zhvilloj aktivitetet rinore dhe kulturore, dhe nuk ka gatishmëri të institucioneve publike për të inkuadruar të rinj në këso lloj aktiviteteve. Objekti i ri i shtëpisë së kulturës është duke u ndërtuar tani. Në këtë komunë funksionon shoqëria kulturore-artistike “Dita”, por pjesëmarrësit në aktivitetet e kësaj shoqërie shprehën se nuk kanë mbështetje të mjaftueshme nga organet komunale.

Premtimet dhe puna e Kryetarit të Komunës

Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme, me komunën e Shtimes ka udhëhequr PDK, përmes tre kryetarëve të ndryshëm. Në mandatin e parë qeverisës (2000-2002) kryetar komune ishte Fehmi Mujota (PDK). Në mandatin e dytë (2002-2007), me komunën udhëhoqi Fatmir Rashiti; kurse në zgjedhjet e 17 nëntorit 2007, PDK konkurroi në postin e kryetarit të komunës me Naim Ismajlin, pesë vite kryeshef komune, i cili në raundin e parë zgjedhor fitoi 4,308 vota apo 42.47%, kurse në raundin e dytë fitoi 5,003 vota apo 71.3%.

Ato pak premtime të cilat kemi mundur ti sigurojmë, premtime të cilat janë dhënë nga kryetari aktual i Komunës së Shtimes në debatet televizive, thuajse janë përmbushur në tërësi ose janë në realizim e sipër. Premtimi më madhor që është dhënë nga ana e kryetarit të kësaj komune ka qenë përfundimi i planit zhvillimor urban. Ky premtim vetëm se është realizuar dhe plani zhvillimor është miratuar në Kuvend Komunal.

Gjithashtu është rregulluar edhe sheshi kryesor i qytetit – sheshi “UÇK”. Përveç rregullimit të sheshit komuna ka bërë edhe shtrimin e rrugës kryesore të qytetit. Edhe pse një projekt madhor dhe me rëndësi për qytetin, shtrimi i rrugës kryesore ka zgjatë shumë kohë me që rast qytetarët janë ndarë shumë më të pakënaqur se më parë. 1181 metra të rrugës kryesore janë shtruar për pesë muaj. E tërë rruga kryesore ka qenë e bllokuar për tërë këta muaj. Për shkak të punimeve edhe ujë nuk ka pasur me rregull për katër muaj. Vonesa në punime është arsyetuar me atë se gjatë kryerjes së punimeve është parë e arsyeshme që të intervenohet edhe në rrjetin e kanalizimit fekale dhe atë atmosferik.

Premtimi për rregullimin e shtratit të lumit Shtimjanja është përmbushur në masë të madhe. Mirëpo, problem mbetet derdhja e tërë kanalizimeve në shtratin e këtij lumi.

Tab.1. Premtimet dhe realizueshmëria e tyre

Premtimet	Realizimi
Do të përfundoj planifikimin zhvillimor urban, ku për këtë projekt në periudhën 2007 - 2008 do të shpenzohen 85 mijë euro, kurse më 2009 do të shpenzohen 50 mijë euro	Gjatë vitit 2008 Komuna ka shpenzuar 70.000 euro për Planin Zhvillimor Urban i cili do të kryhet nga kompania Nga Prishtina “DATA GIS Consulting”, marrëveshje e cila është lidhur me 3 nëntor 2008. Edhe në vitin 2009 komuna ka ndarë mjete për realizimin në tërësi të këtij projekti, i cili vështirë që do të përfundoj më 2009, pasi që punët kanë filluar në fund të 2008
Ndërtimi i “Memorialit të Reçakut”, me që rast do të ndaj 50 mijë euro për hartimin e projektit ideor	Në 2008 është hartuar projekti ideor si dhe është përfunduar faza e parë e memorialit e cila është duke u financuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Pritet tenderimi për fazën e dytë e cila do të kushtoj 1 milion e 200 mijë euro
Rregullimi i Sheshit UÇK	Ky projekt i cili ka kushtuar 51.000 euro është realizuar në tërësi.
Rregullimi i shtratit të lumit Shtimjanja	Projekti është në përfundim e sipër.

Zgjedhjet lokale në Shtime

Në tri palë zgjedhjet e gjertanishme lokale në Komunën e Shtimes, Kuvendi Komunal është dominuar vazhdimisht nga PDK. Në zgjedhjet e para lokale, PDK mori 4,958 vota dhe kështu siguroi 11 ulëse në KK, kurse LDK dhe AAK së bashku morën dhjetë ulëset e mbetura. Edhe në zgjedhjet e dyta lokale dy vite më vonë PDK doli fituese, kësaj radhë më bindshëm. Numri i votave për këtë subjekt u rrit në 6,108 dhe arriti të

siguroj 12 ulëse, kundrejt LDK e cila fitoi 9 ulëse dhe AAK që kësaj radhe nuk arriti të përfaqësohet në Kuvend Komunal. Në zgjedhjet e 2007, pati një rënie të madhe të votave dhe PDK për nga numri i votave u kthye në gjendjen që ishte në vitin 2000. Edhe pse fitoi afro 2,000 vota më pak, sërish PDK doli fituesja më e madhe e zgjedhjeve me 11 ulëse në KK. Kurse pesë partitë tjera së bashku arritën të fitojnë 10 ulëset tjera. Në këto tri palë zgjedhje në nivel lokal kanë konkurruar 14 subjekte politike, por vetëm gjashtë prej tyre kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK: pesë parti dhe një individ i pavarur. Vetëm dy parti (PDK dhe LDK) kanë arrit që të përfaqësohen në tri legjislaturat e gjertanishme komunale.

Tab.2. Partitë të cilat kanë arritur që të fitojnë ulëse në KK të Shtimes.

Partia	Zgjedhjet 2000		Zgjedhjet 2002		Zgjedhjet 2007	
	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK	Nr. i Votave	Ulëse në KK
PDK	4958	11	6108	12	4414	11
LDK	4439	9	5007	9	1449	3
AAK	273	1	-	-	543	1
LDD	-	-	-	-	1219	3
AKR	-	-	-	-	1041	2
Halil Halili	-	-	-	-	482	1

Edhe numri i votuesve ka shkuar duke rënë gjithnjë në tri palë zgjedhjet lokale. Përderisa në zgjedhjet e para lokale dalja e votuesve në zgjedhje ishte 77.8%, në zgjedhjet e dyta kjo shifër ra në 67.55%. Përkundër rënies prej 10% ndërmjet dy palë zgjedhjeve të para lokale, sërish dalja në votime në zgjedhjet e 2002 ishte më e madhe në këtë komunë se në shumicën e komunave tjera, të cilat shumica ranë nën 60%. Edhe pse nuk kemi të dhëna të sakta për numrin e qytetarëve me të drejtë vote në vitin 2007, besohet se numri i qytetarëve me të drejtë vote është rritur dukshëm në 2007, kurse pjesëmarrja në votime ka rënë edhe më tutje. Ky fakt e ul edhe më tutje përqindjen e votuesve që ju kanë përgjigj thirrjes për zgjedhje. Në zgjedhjet e katërta lokale, ato të 15 nëntorit 2009, në Komunën e Shtimes të drejtë vote do të kenë 21,538 qytetarë.

Tab.3. Statistikat e daljes së votuesve në zgjedhjet lokale në Shtime në tri palë zgjedhjet e gjertanishme

	2000	2002	2007
Votues me të drejtë vote	13785	17426	?
Pjesëmarrja në votime	10725	11771	9560
Përqindja e daljes në votime	77.8%	67.55%	?%

Buxheti i Komunës

Buxheti i përgjithshëm i komunës së Shtimes nuk ka pasur rritje të vazhdueshme nga viti në vit. Përderisa në vitin 2004 ka pasur rritje të buxhetit në krahasim me një vit paraprak, në 2005 ka pasur rënie në krahasim me 2004. Në 2006 sërish është vërejtur rritje në krahasim me 2005, për të pasur rënie sërish në 2007. Në dy vitet e fundit ka pasur rritje të buxhetit dhe për herë të parë në historinë e shkurtër të kësaj komune

buxheti i përgjithshëm kalon shifrën 3.2 milion euro. Nga këto mjete, më shumë se 50% shkojnë për rroga dhe mëditje. Kategoria e vetme buxhetore që ka shënuar rritje nga viti në vit është ajo e “subvencione dhe transfere”.

Tab.4. Shpenzimet buxhetore sipas viteve dhe sipas linjave buxhetore

Viti	Rrogat dhe mëditjet	Mallrat dhe shërbimet	Shpenzimet komunale	Subvencionet dhe transferet	Shpenzimet kapitale	Rezervat	Gjithsej
2009	€1,900,490	€354,092	€109,272	€61,000	€809,228	-	€3,234,082
2008	€1,660,218	€432,989	€120,372	€55,000	€290,146	-	€2,558,725
2007	€1,600,987	€305,288	€111,242	€53,000	€216,889	-	€2,287,406
2006	€1,581,264	€281,058	€82,455	€45,000	€367,004	-	€2,356,781
2005	€1,516,338	€310,541	€76,220	€11,937	€175,768	-	€2,090,804
2004	€1,583,198	€488,920	-	-	€165,639	€46,127	€2,283,884
2003	€1,134,818	€449,784	-	-	€170,000	€16,084	€1,770,686

Sa i përket shpenzimit të buxhetit, gjatë vitit të kaluar komuna e Shtimes ka treguar një kapacitet të ulët në menaxhimin me buxhetin. Deri në fund të 2008 janë shpenzuar vetëm 61% e mjeteve në dispozicion. Kjo shifër prej 61% e rëndit këtë komunë në vendin e 27 në krahasim me komunat tjera për nga aftësia e menaxhimit me buxhetin që ka në dispozicion. Edhe në realizimin e të hyrave vetanake kjo komunë nuk ka treguar sukses në krahasim me komunat tjera dhe në krahasim me planifikimet buxhetore që janë bërë në vitin 2008. Shtimja është njëra ndër tetë komunat e Kosovës e cila nuk ka arrit që të arkëtoj të hyrat vetanake në masën 100% në krahasim me planifikimet buxhetore. Deri në fund të 2008 komuna e Shtimes ka arritur të arkëtoj 76.55% të mjeteve dhe sërish rangohet e 27 sa i përket aftësisë për të arkëtuar mjetet vetanake.

Investimet kapitale

Në 2009, nga buxheti komunal prej 3.2 milion euro, 809,228 € kanë qenë të destinuara për investime kapitale. Shuma për investime kapitale është rritur ndjeshëm nga viti 2008. Në të gjitha këto vite (2003-2009) buxheti i komunës për investime kapitale, marrë së bashku, ka qenë 2,194,674 €. Me rreth një milion euro që ka pas komunë dy viteve të fundit për investime kapitale, janë realizuar projekte me shumë të vogla parash. Tabela më poshtë pasqyron disa nga projektet që janë realizuar në këto dy vite.

Tab.5.: Investimet kapitale në Shtime gjatë 2008 dhe 2009

Viti	Emri i projektit	Shuma e Projekteve
2008	Asfaltimi i rrugës “Jetë Hasani”	€48,350
2008	Ndërtimi i parkut të dëshmorëve në Petrovë	€14,000
2008	Rehabilitimi i rrugës Petrovë-Mollopolc	€23,101
2008	Ndërtimi i kanalizimit fekal dhe asfaltimi i rrugës “14 Dhjetori”	€30,000
2009	Rregulli i tretuarit të rrugës “Komandant Kumanova”	€61,498
2009	Rregulli i tretuarit Shtime-Belinc-Carralevë	€60,000
2009	Asfaltimi i rrugës së qytetit të Shtimes	€49,755

Kuvendi Komunal i Shtimes ka miratuar edhe Buxhetin e Komunës për vitet 2010-2012. Sipas vlerësimeve, në tri vitet në vazhdim, komuna e Shtimes do të ketë në dispozicion një total prej 3,317,450 euro për investime kapitale.

Tab.6.: Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës së Shtimes 2010-2012

Buxheti	2010	2011	2012
Buxheti i përgjithshëm në €	3,665,207	3,783,071	3,910,798
Të hyrat vetanake në €	372,511	384,337	395,423
Investimet kapitale në €	1,067,420	1,106,338	1,143,692

Nëse mund të japim një vlerësim të përafërt edhe për vitin 2013, duke u bazuar në vlerësimet buxhetore 2010-2012, atëherë mund të përfundojmë se kryetari i ardhshëm i komunës së Shtimes për mandatin e tij qeverisës katërvjeçar do të ketë në dispozicion rreth 4.4 milion euro për investime kapitale.

Administrata komunale

Në sektorin publik në këtë komunë janë të punësuar 623 punonjës. Prej tyre 66 janë të punësuar në administratën e komunës, kurse pjesa tjetër në arsim dhe shëndetësi. Nëse llogarisim përmes formulës 1 shërbyes civil për 620 banorë (vendimi i Qeverisë së Kosovës nr.10/46, 3 dhjetor 2008), del se kjo komunë nuk ka staf të mjaftueshëm dhe duhet që të rekrutoj staf edhe më tutje deri sa të arrij shifrën pre 100 punonjësish në administratën komunale.

Tab.7. Numri i punonjësve në sektorin publik në Komunën e Shtimes sipas viteve

Viti	Nr total i të punësuarve në arsim, shëndetësi dhe administratë
2009	623 ▲
2008	620
2007	623
2006	645 ▲
2005	641
2004	660 ▲
2003	579 ■

Objekti i administratës komunale të Shtimes ofron kushte të mira për zhvillimin e punës dhe pritjen e palëve. Administrata është efektive në kryerjen e shërbimeve dhe qytetarët nuk ankohen me punën e administratës. Në gjashtë drejtori komunale sa ka ekzekutivi i kësaj komune, në gjashtë mujorin e parë të 2009 ka pranuar 1,137 dhe ka arritur të zgjidh 94.28% prej tyre.

Komuna e Shtimes dhe Ligji për Vetëqeverisje Lokale

Gjatë vitit 2008, Kuvendi Komunal i Shtimes ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, kurse në periudhën janar-qershor 2009 KK i Shtimes ka mbajtur gjashtë mbledhje. Edhe Komiteti për Politikë dhe Financa gjatë 2008 ka mbajtur 12 mbledhje të rregullta, kurse në gjashtë mujorin e parë të 2009 ka mbajtur gjashtë mbledhje. Përveç

KPF-së, KK i Shtimes ka të themeluar vetëm edhe një komitet tjetër, por nuk janë themeluar komitetet konsultative ashtu siç e parasheh Ligji për vetëqeverisje lokale. Kryetari i Komunës së Shtimes gjatë 2008 ka mbajtur dy takime publike, kurse në gjashtë mujorin e parë të 2009 nuk ka mbajtur asnjë tubim publik me qytetarë. Ligji për vetëqeverisje lokale parasheh që komuna të mbaj dy tubime publike në vit, njërin prej tyre në gjashtë mujorin e parë të vitit. Gjatë 2008 në Komunën e Shtimes është paraqitur një peticion i cili është shqyrtuar, kurse në pjesën e parë të 2009 nuk është paraqitur asnjë peticion apo kërkesë për qasje në dokumente zyrtare. Gjatë vitit 2008, kryetari i Komunës së Shtimes nuk ka paraqitur asnjë herë raport para KK-së, kurse ligji e parasheh që kryetari të jap raport çdo gjashtë muaj ose sa herë që kërkohet nga KK.

Ueb faqja e KK Shtime është e mirëmbajtur në baza të rregullta kohore. Është e pajisur me informacione të shkëlqyeshme aq sa një qytetari të Shtimes do t'i nevojiteshin rreth aktiviteteve të komunës. Tabela më poshtë tregon që në ueb faqen e KK Shtime ka zbrazëti të konsiderueshme në lidhje me informacione të pakta lidhur me shërbimet dhe projektet komunale si dhe mungojnë informacione lidhur me legjislacionin komunal.

Tab.8. Niveli i përmbajtjes së informacioneve në ueb-faqen zyrtare të Komunës së Shtimes (www.shtime-komuna.org)

Kategoritë e informacioneve	Niveli i informatave ²
Ballina	4
Organizimi komunal	2.67
Shërbimet komunale	2.4
Info rreth qytetit	3.13
Projektet komunale	2.5
Lajme & lajmërim	4
Harta e faqes	3
Kontakt	5
Gjuhët	4
Fusha për kërkim	5
Tjera informacione shtesë	2
Baza Ligjore	2
Mesatarja totale	3.31
Renditja në krahasim me ueb faqet e komunave tjera	10

Gjendja në arsim

Në komunën e Shtimes funksionon vetëm një shkollë e mesme dhe 7 shkolla fillore të cilat kanë 13 paralele të ndara. Në Komunën e Shtimes nuk funksionon asnjë çerdhe. Në përgjithësi, gjendja e objekteve është në gjendje të mirë, përveç objektet e paraleleve të ndara të cilat janë në gjendje të rëndë. MASHT ka vënë gurëthemelin për tri shkolla të reja në këtë komunë, një në Shtime, një në Mollapollc dhe një në Gllavicë. Ndërtimi i shkollës në Shtime do të kushtoj 1 milion e 300 mijë euro dhe do

² (rradhitja nga 1 deri 5) 5 - shkëlqyeshëm, 4-shumë mirë, 3-mirë, 2-mjaftueshëm, dhe 1-dobët.

të ketë 18 klasë. Ndërtimi i shkollës në Gllavicë ka qenë më se i domosdoshëm, ngase edhe më tutje, deri në përfundimin e objektit të shkollës së re, nxënësit e Gllavicës udhëtojnë dy orë këmbë për të ndjekur mësimin në Koshare, që i takon komunës së Ferizajt. Maturantët e Komunës së Shtimes, shkollës së vetme të mesme “Naim Frashri”, në testin e maturës kanë treguar rezultat të dobët, që e radhit këtë komunë në vendin e parafundit pas Komunës së Kastriotit. Në vitin 2008, në testin e parë ata kanë arritur një kalueshmëri prej vetëm 10%, por më vonë kjo përqindje është rritur në 27.3%, pasi që MASHT ka ulur kriteret e kalueshmërisë. Kurse në vitin 2009 vërehet një përmirësim i vogël në testet e maturës, por sërish në krahasim me komunat tjera rezultatet e maturës në shkollën e mesme të Shtimes janë të ulëta (rreth 20% në afatin e qershorit 2009).

Gjendja në shëndetësi

Komuna e Shtimes ballafaqohet me probleme të mëdha në fushën e shëndetësisë, probleme të cilat trashëgohen nga mandatet e kaluara. Problemet më të mëdha në shëndetësinë primare të Shtimes janë mungesa e stafit të kualifikuar shëndetësor. Institucionet shëndetësore përballen me mungesë të barnave, QKMF ka vetëm dy autoambulanca të vjetra. Edhe pse para disa muajve është blerë një autoambulancë në vlerë prej 13 mijë eurosh ajo nuk është funksionale. Të vetmin investim kapital që ka parapa komuna për vitin 2009 është blerja e një autoambulance në vlerë prej 40,000 euro. Në këtë komunë funksionon edhe instituti i shëndetit mental.

Shoqëria civile

Në komunën e Shtimes nuk ka shoqëri civile aktive. Edhe pse janë formuar një numër i madh i organizatave jo qeveritare, këto OJQ tani thuajse e kanë shuar aktivitetin e tyre. Shumica e organizatave jo qeveritare që kanë qenë aktive janë marrë me aktivitete rinore. Më aktive nga OJQ-të lokale është “Feniks”, por kjo organizatë zakonisht është aktivizuar herë pas here, dhe kryesisht në kohën e zgjedhjeve. Tani së fundmi, organizata jo qeveritare INPO nga Ferizaj ka filluar monitorimin e Kuvendit Komunal dhe komunës në përgjithësi. Mirëpo, kjo organizatë nuk ka zyre në këtë komunë, është vetëm në hapat e parë të funksionimit të saj dhe nuk është në atë nivel të profesionalizmit dhe angazhimit që kjo OJQ ka në Ferizaj. Edhe organizata “Hendikos” është aktive në këtë komunë. Udhëheqësi i “Hendikos” është edhe kandidat për asamblenë komunale. Pensionistët e kësaj komune nuk kanë arritur që të hapin degën e tyre në Shtime.

Mediat lokale

Në Komunën e Shtimes funksionon vetëm një radio lokale, Radio “Zëri i Shtimes”. Programet e kësaj radioje janë të orientuara nga programet argëtuese. Edhe pse ka program informativ, kjo radio nuk ka gazetarë të rregullt që do të mbulonin këtë komunë në mënyrë objektive. Edhe pse shumë gazetarë shkruajnë për Shtimen, asnjëri prej tyre nuk është me vendbanim të përhershëm në këtë komunë. Zakonisht reporterët e gazetave e mbulojnë Shtimen nga komunat tjera. Gazetari i “Zëri”-t shkruan për Shtimen dhe është me vendbanim në Lipjan; kurse gazetarët e “Koha Ditore” dhe “Express” janë me banim në Ferizaj.

Rendi dhe ligji në Komunën e Shtimes

Nga 1 janari 2008 deri 31 dhjetor 2008, në Komunën e Shtimes kanë ndodhur 574 raste të shkeljes së rendit dhe ligjit, në gjithsejtë 44 shkelje të natyrave të ndryshme. Shkeljet më të mëdha kanë ndodhur në këto fusha:

Tab.9. Numri i rasteve më të shpeshta të shkeljes së rendit dhe ligjit në Shtime (2008)

Natyra e shkeljes së rendit dhe ligjit	Numri i rasteve të shënuara
Aksidente	99
Prishja e rendit dhe qetësisë publike	27
Pengim i personave zyrtar në kryerjen e punës	7
Vjedhje e pyjeve	4
Incidente lidhur me pronën	13
Vjedhje	136
Abuzime seksuale	0
Shkaktim të dëmtimeve trupore	19
Kërcënime	29
Mashtrime	7
Vrasje	0
Incidente në baza etnike, religjioze apo racore	1

Tatimi në pronë

Bazat për vënien e tatimit në pronë në Kosovë ende përlogariten sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29 për tatimin mbi pronën e paluajtshme në Kosovë. Sipas kësaj rregulloreje, Kuvendi Komunal i çdo komune i cakton tarifat tatimore mbi pronën në bazë vjetore në shkallën prej 0.05 % dhe 1 % të vlerës së pronës në treg. Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës: pronë për banim, pronë komerciale, pronë industriale dhe pronë bujqësore. Në bazë të kësaj, Kuvendi Komunal i Shtimes në shtator 2009 ka miratuar Rregulloren për Tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2010. Sipas kësaj rregulloreje, komuna e Shtimes ndahet në katër zona, dhe normat tatimore sillen nga 0.10% deri 0.20%.

Tab.10. Tatimi në pronë në Komunën e Shtimes

Zona	Pronë për banim		Prona komerciale	Prona Industriale	Prona bujqësore
	Banesa	Shtëpi			
	Norma tatimore				
	0.12%	0.12%	0.20%	0.15%	0.10%
I	320€*	320€	500€	300€	70€
II	250€	250€	300€	230€	60€
III	200€	200€	250€	150€	40€
IV	150€	150€	200€	100€	20€
V	100€	100€	110€	80€	20€

* Vlera e tregut për metër katror.

Kostoja për biznese

Në komunën e Shtimes funksionojnë rreth 515 biznese të llojeve të ndryshme. Në këtë komunë për shumë vite radhazi është duke u tentuar që të funksionalizohet parku teknologjik sllloven “Technopolis” mirëpo nuk ka asgjë konkrete në këtë drejtim. Kompania kosovare SME “Kosova” që gjendet në Davidovc të Shtimes dhe që është partnere vendore e slllovenëve ka premtuar që në parkun teknologjik do të vendosen 25 biznese në Shtime. Kuvendi Komunal i Shtimes ka miratuar Rregulloren komunale për taksa, ngarkesa dhe gjoba, me të cilën parasheh çmimet për leje të çdo lloj biznesi në zonat e ndryshme të kësaj komune. Tabela më poshtë pasqyron disa nga bizneset kryesore në këtë komunë dhe çmimet që ato duhet të paguajnë për leje.

Tab.11. Llojet e bizneseve dhe taksa vjetore që janë të detyruara të paguajnë për leje të punës

Lloji i biznesit	Taksa vjetore e punës
Bankat	175€
Kompanitë e sigurimit	175€
Minierat	225€
PTK komunikimi dhe distribucioni	175€
Barnatoret	100€
Agjensionet turistike	100€
Hotelet	100€
Motelet	100 - 130€
Supermarketet-Hipermarketet	150€
Vetëshërbimet - Minimarketet	100€
Kafeteritë	150€
Restorant	100€
Kontrolli teknik i automjeteve	175€
Gurthyesit	200€
Industria e stolive	175€
Punëtoritë (argjendaritë, zdrukthtaritë, automekanikët, bukëpjekësit, floktar, etj.)	27 - 75€
Depot ndërtimore	150€
Pompat e benzinës	150€
Ndërmarrjet ndërtimore	150€
Veprimtaritë e pavarura profesionale (mjekët, stomatologët, avokaturat, arkitektët, etj.)	50 - 100€